

The background features a light blue, semi-transparent image of a modern, multi-story building with a grid-like network overlay on its facade, suggesting digital connectivity and infrastructure.

# **Përdorimi i nënshkrimit elektronik dhe nevoja për sensibilizimin e bankave me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimeve**

**Deniz Deralla**

Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes,  
Banka e Shqipërisë

# Kuadri ligjor e rregullativ

- Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”;
- Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Rregullorja “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”;
- Rregullorja “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

# Kuadri rregullativ për transparencën

- Në aktet nënligjore të mbikëqyrjes bankare, kryesisht lidhur me kërkesat rregullatore për mbrojtjen e klientit dhe në veçanti përsa lidhet me transparencën e produkteve dhe shërbimeve apo produkteve bankare të ofruara për individin, përcaktohet se:

... kontrata e bankës me klientin duhet të jetë me shkrim....

... por ***nuk specifikohet*** nëse i referohet shkresës apo dokumentit të shkruar ***në formë elektronike***.

# Ndryshimet në kuadrin rregullativ

- Ndryshimet e realizuara në vitin 2015 në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, krijojnë mundësinë për bankat për t’i paraqitur konsumatorit informacionin parakontraktor tanimë **jo vetëm me shkrim** (me shkresë), por edhe nëpërmjet një **mjeti tjetër të qëndrueshëm të komunikimit (e-mail, disketë, CD-ROM, DVD) që plotëson disa kushte sigurie.**
- Kjo risi e rregullores vjen në një linjë edhe me ndryshimet e fundit në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i cili bën përcaktimin e **mjetit të qëndrueshëm** si një mjet **që i mundëson konsumatorit ruajtjen e informacionit të drejtuar personalisht atij, në mënyrë që të lejojë referimin për qëllime informimi, në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur.**
- Ndryshimet rregullative të Bankës së Shqipërisë synojnë promovimin edhe të metodave më të avancuara të komunikimit virtual me klientët, në kushtet kur bankat po investojnë sot **në teknologjitë inovative.**

# Kuadri ligjor për nënshkrimin elektronik

- Sipas dispozitave të ligjit “Për nënshkrimin elektronik” përcaktohet se ***dokumenti elektronik i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore***... si dhe

***...specifikohet se nëse veprimi juridik është një kontratë, atëherë secila prej palëve duhet të nënshkruajë të njëjtin dokument me nënshkrimet elektronike të kualifikuara përkatëse.***

# Kuadri ligjor për nënshkrimin elektronik (vazhdim)

- Në kuptimin e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë, përsa kohë kuadri ligjor i posaçëm për nënshkrimin elektronik, siguron barazimin e dokumentit elektronik dhe formës shkresore, nuk bëhen pengesë për aplikimin e nënshkrimit elektronik.
- Bankat tregtare, në bazë dhe për zbatim të kuadrit ligjor dhe atij rregullativ në fuqi për nënshkrimin elektronik, mund ta përdorin lirisht atë gjatë veprimtarisë së tyre, ndërkohë që mënyra se si do të realizohet nënshkrimi (në formë shkresore apo elektronike) mbetet një çështje teknike që realizohet bazuar në analizat e detajuara të kostove dhe përfitueshmërisë nga vetë bankat e sistemit.

# Në përfundim

- Banka e Shqipërisë vlerëson dhe mbështet nismat për sensibilizimin e bankave për rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare, midis të tjerash edhe nëpërmjet përdorimit të nënshkrimit elektronik.
- Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve bankare, edhe nëpërmjet ndryshimeve rregullative të nevojshme.
- Edhe gjatë vitit 2016 parashikohet të realizohen disa ndryshime në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.



**Ju falënderoj për vëmendjen!**